



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2019:148375

Datë: 06.09.2024

Numri i dokumentit: 06133007

C.nr. 201/2018

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NE DEÇAN, Departamenti i Përgjithshëm, civilo-jurdike e shkallës së parë më gjyqtarin Bekim Avdimetaj në çështjen juridiko kontesti morë të paditësit I. (H) Z. nga fshati L., K, e D., të cilin e ka përfaqësuar avokati B.H.nga Gj., kundër të paditurit S. (A) J. dhe V. (S) J. qe te dyte nga fshati J.,K. e D. për kthimin e huas gjykata pas përfundimit te seancës te shqyrtimit kryesore publike me date 04.09.2024 në prani të autorizuarit te paditësit te paditurit te dyte te përpiluar me date 06.09.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit I. (H) Z. nga fshati L. K. e D. të cilin e ka përfaqësuar avokati B. H. nga Gj.

II. DETYROHEN te padituri S. (A) J. dhe V. (S) J. qe te dyte nga fshati J., K. e D. te ja kthejnë huan në të holla prej.....euro , paditësit I. (H) Z. nga fshati L. K. e D., me kamat prej 8% nga dita e paraqitjes te padis ne gjykatë me date 25.07.2018 e gjeri ne pagesën definitivë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit më dhune.

III.DETYROHEN te paditurit solidarishtë paditësit te ja paguajnë për shpenzimet e procedurës kontesti morë shumen prej 752.30 euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes se aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditës I. (H) Z. nga fshati L. K.e D. të cilin e ka përfaqësuar avokati B. H. nga Gj., ka paraqitur padi në këtë gjykatë më datën 25.07.2018, kundër të paditurit S. (A) J. dhe V. (S) J. qe te dyte nga fshati J. K.e D. për kthimin e huas shumen e te hollave prej.....euro.

Juridiksioni dhe kompetenca e gjykatës

Neni 37 par.1 i Ligjit të Procedurës Kontesti morë parashihet, nëse me ligj nuk është caktuar kompetenca ekskluzive territoriale e ndonjë gjykate tjetër, për procedimin e çështjes është kompetente gjykata e kompetencës së përgjithshme për palën e paditur.

Pretendimet e palëve dhe te autorizuarve te tyre

I autorizuari i paditësit avokati B. H. gjate seancës te shqyrtimit përgatitorë ,kryesorë dhe ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë të dhënave të paraqita si në padi ashtu edhe në seancat e kaluar. Konsideroj se gjykata ka në disponim prova të mjaftueshme që këtë çështje kontestuese juridike të merre vendim meritore.

Ndërgjyqësit me kontratën e datës....., janë pajtuar mes tyre që pala paditëse të ja huazojë palës së paditur shumën e të hollave në lartë prej.....euro. Me afat kthimi deri me datë 01.08.2015, duke u llogaritur këtu edhe kamatën ligjore në lartësi prej 8%, në bazë vjetorë duke filluar nga dritarta e paraqitjes së padisë në gjykatë me datë 25.07.2018 e deri në pagesën definitivë. Kjo kontratë është nënshkruar nga ana e të dyja palëve. Mirëpo, pala e paditur nuk ka arritur që ta përmbushë detyrimin e tij për kthimin e të hollave të huazuara. Ndaj mbi këtë bazë vlerësojmë se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore që gjykata pas administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre të merre aktgjykim mbi aprovimin e kërkesë padisë të paditësit si të bazuar. Shpenzimet proceduralë i kërkojmë dhe atë: në emër të padisë, mbajtjes së 4 seancave të plota si dhe 6 seancave që janë shtyrë në shumë të përgjithshme prej 1.095 euro.

I padituri i dytë V. (S) J. qe te dyte nga fshati J. K. e D. gjate seancës te shqyrtimit përgatitorë ,kryesorë dhe ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se i kundërshton deklarimet e të autorizuarit të paditësit te lartshënuar duke e kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit ne tersi. Duke i propozuar gjykatës qe ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si te pa bazuar . I kërkoj shpenzimet e procedurës.

Nga kontrata mbi huajnë e lidhur në Gjakovë me datë 01.08.2014 te avokati B.H. ne Gj.vërtetohet fakti se është lidhure në mes paditësit I. (H) Z., nga fshati L., K. e D., me te paditurit S. (A) J. dhe V. (S) J. qe te dytë nga fshati J., K. e D. në shumën prej.....euro. Me afte kthimi të huas nga te paditurit paditësit si me larte deri me datën 01.08.2015. Te cilën kontratë e kanë nënshkruar palët ndërgjyqëse te lartshënuar dhe dëshmitari I. K., nga fshati M., K. e D.

Neni 8 par.1. Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit.

Neni 15 Lidhja e kontratës Kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elementet thelbësore të kontratës.

Neni 572 par.1. Huamarrësi ka për detyrë që në afatin e kontraktuar t'i kthejë sendet e marra hua në sasi e në cilësi të njëjtë te Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve.

Gjykata ne seancën e caktuar te shqyrtimit kryesore me date 04.09.2024 ne ora 10:00 edhe pse e ka ftuar te paditurin e pare S. (A) J. nga fshati J. K. e D. me ftes ne mënyre te rregullt dhe nga flet kthesa e kthyer ne gjykate me datën 07.06.2024 është e nënshkruar qe ka pranuar dhe për arsyen e mosardhjes nuk e ka njoftuar gjykatën me ndonjë parashtrese me shkrim ,andaj gjykata ka vepruar ne kuptim te nenit 151,423 par. 4 te LPK.

Administrimi i provave gjate seancës te shqyrtimit kryesore

- Lexohet padia e paditësit e dorëzuar në gjykatë me datë 25.07.2024,
- Lexohet kontrata mbi huanë e lidhur në Gj. me datë.... te avokati B. H., në mes të I. (H) Z., nga fshati L., K.e D., S. (A) J. dhe V. (S) J., nga fshati J., K.e D., në shumën prej Euro, të cilën kontratë e kanë nënshkruar palët ndërgjyqëse dhe dëshmitari I.K., nga fshati M. K. e D.
- Lexohet përgjigja në padi e dorëzuar në gjykatë me datë 22.02.2020, e dhënë nga të paditurit S. (A) J. dhe V. (S) J..

Te cilave fakteve qe gjenden ne shkresat e lendes gjykata ja ka falur besimin.

Gjykata duke çmuar me kujdes çdo provë veç e veç dhe te gjitha atyre se bashku dhe nga kjo gjendje e vërtetuar faktike si më larte, erdhi ne përfundim dhe vërtetoj ne mënyrë te pa dyshimte kërkesëpadia e paditësit është në tersi e bazuar dhe ne kuptim te nenit 8 par.1, nenit 15 dhe nenit 572 par.1. te Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve te Republikës se Kosovës duke vendosur si ne piken **I** dhe **II** te dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimin qe te paditurit, paditësit solidarisht te ja paguaj shpenzimet e procedurës kontesti morë, gjykata e mbështeti në dispozitat e nenit 449 par.1, 2 452 par. 2 dhe 463 par. 2 të LPK-së, sepse paditësi si gjyq fituese i takon e drejta në shpërblimin e shpenzimeve të procedurës më kusht që i njëjti këto shpenzime i autorizuari i paditësit Av. B.H. nga Gjakova ti ketë specifikuar sipas të Tarifës së Odes se Avokatëve të Kosovës dhe atë për përpilimin e padis 104.00 euro, për takse për padi 40.00 euro, për përfaqësim te paditësit ne 4 seanca 4x135,20 seanca gjyqësorë ne shumë prej 540.80 euro për një seance te shtyre me kërkesë te paditurit te dyte me date 26.07.2023 ne shemën prej 67.50 euro, te gjitha këto ne shumë të përgjithshme prej 752.30 euro . Mbi ketë shumë refuzohen si te pa bazuar .

Nga sa u tha me larte u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

NGA GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA DEÇAN

G J Y Q T A R I
Bekim Avdimetaj

KËSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa ne afat prej 15 ditësh Gjykatës së Apelit ne Prishtinë e përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:148375
Datë: 06.09.2024
Numri i dokumentit: 06133007